

327. Në bazë të nenit 49-b të Statutit të Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 16/05, 8/10, 17/11, 2/12, 18/13, 13/14, 1/15 dhe 12/15), Komisioni për dispozita dhe punë administrative i Këshillit të Qytetit të Shkupit, në seancën e mbajtur më 25 shtator të vitit 2018, përcaktoi tekstin e pastruar të Statutit të Qytetit të Shkupit.

Teksti i pastruar përfshin Statutin e Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 16/05), Vendimin statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 8/10), Vendimin statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 17/11), Vendimin statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 18/13), Vendimin statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 13/14), Vendimin statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 1/15) dhe Vendimin statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 12/15), në të cilët është shënuar koha e hyrjes së tyre në fuqi.

Numër 27-8304/5
25 shtator viti 2018
Shkup

KOMISIONI PËR DISPOZITA
DHE PUNË ADMINISTRATIVE
KRYETAR,
Konstantin Kratovaliev, n.p.

STATUTI I QYTETIT TË SHKUPIT

(Tekst i pastruar)

I . Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Qyteti i Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale është themeluar dhe territori i tij është përcaktuar me Ligjin për Qytetin e Shkupit (“Gazeta zyrtare e RM” 55/04 dhe 158/11).

Territorin e Qytetit të Shkupit e përbëjnë territoret e komunave: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Kisela Vodë, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare, të themeluara me Ligjin për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e RM” numër 55/04).

Neni 2

Me këtë statut të Qytetit të Shkupit, në përputhje me ligjin, rregullohen:

- organizimi dhe puna e organeve të Qytetit të Shkupit;
- përbërja dhe organizimi i punës së komisioneve të Këshillit të Qytetit të Shkupit;
- kryerja e punës në përputhje me parimet e subsidiaritetit;
- mënyra e informimit të qytetarëve dhe qasja e lirë në informatat me karakter publik;
- rastet e mospjesëmarrjes së publikut në seancat e Këshillit të Qytetit të Shkupit;
- mënyra dhe procedura e dorëzimit të parashtrësave dhe propozimeve për punën e organeve të Qytetit të Shkupit dhe veprimin sipas tyre;
- mënyra e organizimit të tribunave publike, zbatimi i anketave dhe mbledhja e propozimeve nga qytetarët;
- mënyra e shpalljes së dispozitave të Këshillit;
- mënyra e realizimit të obligimeve nga fusha e mbrojtjes në gjendje lufte;
- mënyra e kryerjes së obligimeve nga fusha e sigurisë, mbrojtjes dhe shpëtimit në gjendje krize dhe fatkeqësi elementare;
- mënyra dhe procedura për caktimin e stemës dhe flamurit të Qytetit të Shkupit;
- si dhe çështje të tjera të rëndësishme për Qytetin e Shkupit.

Neni 3

Çështje të caktuara të lidhura me kompetencat, procedurat për punë dhe vendime në Këshillin e Qytetit të Shkupit, konkretisht rregullohen me rregulloren e Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm : rregullore).

Rregulloren e sjell Këshilli i Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli), me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Neni 4

Qyteti i Shkupit është person juridik me seli në bul. "Ilinden" nr. 82 Shkup.

Neni 5

Qyteti i Shkupit posedon vulën.

Vula e Qytetit të Shkupit ka formë rrethore me diametër 32 mm, në mesin e së cilës është vizatuar stema e Qytetit, ndërsa rreth tij në gjysmën e sipërme të rrethit në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik është shkruar teksti: "Република Македонија – Град Скопје - Скопје", ndërsa në gjysmën e poshtme të rrethit është shkruar në gjuhën shqipe dhe alfabetin e gjuhës shqipe teksti: "Republika e Maqedonisë - Qyteti i Shkupit - Shkup"

Neni 6

Qyteti i Shkupit posedon stemën.

Stema e Qytetit të Shkupit ka formë mburoje, në të cilën ana e sipërme ka formë gjysmëharku të kthyer nga brenda, këndin e majtë dhe të djathtë e përbëjnë dy linja të pjerrëta, ndërsa anët e poshtme janë harqe të rrumbullakosura nga jashtë që mbarojnë me majë në mesin e boshtit të poshtëm.

Në hapësirën e mburojës gjendet: Ura e gurit me lumin Vardar, kështjella e Kalasë së Shkupit dhe majat me borë të malit të Sharrit.

Neni 7

Qyteti i Shkupit posedon flamurin.

Flamuri i Qytetit të Shkupit është i kuq, ndërsa në këndin e majtë të tij, afër shtizës gjendet stema e Qytetit të Shkupit, e vulosur me ngjyrë të verdhë.

Raporti ndërmjet gjerësisë dhe gjatësisë të flamurit është një me dy.

Neni 8

Në qytetin e Shkupit krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, gjuhë zyrtare është edhe gjuha shqipe dhe alfabeti i saj, si gjuhë dhe shkrim që e përdorin qytetarët si përkatës të bashkësisë e cila merr pjesë me mbi 20% në numrin e përgjithshëm të banorëve në Qytetin e Shkupit.

Neni 9

Qyteti i Shkupit ka festën e tij.

Festa e Qytetit të Shkupit është 13 Nëntori, Dita e Çlirimit të Shkupit.

Neni 10

Në Qytetin e Shkupit shënohet Dita e solidaritetit, si shenjë respekti për viktimat e tërmetit të datës 26 korrik 1963 dhe falënderimi për solidaritetin e shprehur vendas dhe ndërkombëtar për përtëritjen dhe ndërtimin e Shkupit

Neni 11

Qyteti i Shkupit ndan Çmimin "13 Nëntori".

Çmimi ndahet si shenjë mirënjohjeje për rezultatet e arritura në ekonomi, shkencë, art, kulturë, edukim dhe arsim, mbrojtje shëndetësore, mbrojtje, mbrojtje

sociale, sport, kulturë teknike, mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor dhe të natyrës, si dhe në segmente të tjera të jetës, punës dhe krijimtarisë, që përfaqësojnë një kontribut të veçantë për zhvillimin e Qytetit të Shkupit dhe për përparimin dhe afirmimin e plotë të tij në Republikën e Maqedonisë dhe në mbarë botën.

Neni 12

Çmimi mund t'u ndahet personave fizik dhe juridik nga Qyteti i Shkupit, nga Republika dhe nga shtete të tjera, si dhe organizatave ndërkombëtare dhe asociacioneve ose përfaqësuesve të tyre.

Neni 13

Për çmimin "13 Nëntori", Qyteti i Shkupit formon këshillin për ndarjen e çmimit "13 Nëntori".

Puna e këshillit prej së afërmi rregullohet me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Mjetet për çmimin dhe punën e këshillit sigurohen nga buxheti i Qytetit të Shkupit dhe nga burime të tjera të të ardhurave.

Neni 14

Qyteti i Shkupit mund të vendosë çmime të tjera dhe mirënjohje në trajtë të: pllakateve, kartave, dhe diplomave.

Mirënjohjet nga paragrafi i mëparshëm u ndahen bartësve të funksioneve publike dhe shoqërore, qytetarëve, shoqërive tregtare, institucioneve dhe shërbimeve publike, si dhe politikanëve, anëtarëve të organizatave ndërkombëtare dhe asociacioneve dhe qytetarëve nga shtetet e tjera, për kontribut të veçantë për zhvillimin e Qytetit të Shkupit ose si shenjë mirënjohjeje për zhvillimin e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve miqësore.

Neni 15

Qytetarë të shteteve të tjera, me merita të veçanta për fuqizimin e paqes dhe bashkëpunimit paqësor ndërmjet popujve dhe shteteve ose me merita të veçanta në fushën e shkencës, kulturës dhe fusha të tjera të jetës shoqërore në përgjithësi, dhe veçanërisht nëse me punën e tyre kanë kontribuar për afirmimin dhe zhvillimin e Qytetit të Shkupit dhe Republikës së Maqedonisë, në tërësi, mund të shpallen për qytetarë nderi të qytetit të Shkupit.

II. Organizimi dhe puna e organeve të Qytetit të Shkupit

1. Këshilli i Qytetit të Shkupit

a) Konstituimi

Neni 16

Konstituimi i Këshillit kryhet me verifikimin e mandatit të anëtarëve të zgjedhur në mënyrë të përcaktuar me ligj dhe dhënie nënshkrim e deklaratës solemne me përmbajtje të përcaktuar me ligj.

(paragrafi 2 dhe 3 shlyhen)

Neni 17

Procedura për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit, konkretisht përcaktohet me rregulloren.

b) Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit

Neni 18

Anëtari i Këshillit ka të drejta dhe obligime të përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut.

Anëtari i Këshillit i fiton këto të drejta dhe obligime pas verifikimit të mandatit.

Anëtarit të Këshillit mund t'i mbarojë ose mund t'i merret mandati sipas kushteve të parashikuara me ligj dhe në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me rregulloren.

Neni 19

Anëtari i Këshillit ka të drejtë dhe obligime:

- të propozojë diskutime për çështje shfaqje dhe gjendje nga kompetencat e Qytetit të Shkupit, si dhe për ato me rëndësi për qytetarët;
- të japë iniciativa për marrjen e vendimeve dhe akteve të tjera nga kompetencat e Këshillit, dhe të propozojë amendamente, sipas mënyrës dhe procedurës të parashikuara me Rregulloren;
- të kërkojë nga administrata e Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm – administrata e qytetit), si dhe nga shërbimet publike, të formuara nga Qytetit i Shkupit, të dhëna dhe informacione për probleme të sferës së tyre të veprimit, që janë të nevojshme për punën e Këshillit, si dhe të kryej kontroll mbi punën e tyre;
- të kërkojë dhe të marrë ndihmë nga administrata e qytetit për përgatitjen e propozimeve që ai ia dorëzon Këshillit, për parashtrimin e pyetjeve të këshilltarëve dhe kryerjen e punëve të tjera që ia ka besuar Këshilli, përkatësisht komisioni ku ai është anëtar;

- ti ruaj si sekret të dhënat që do t'i mësojë nga seanca e këshillit ose të komisioneve të tij, të cilat janë të caktuara si të tilla;
- të realizojë të drejta e obligime të tjera në përputhje me Ligjin për Qytetin e Shkupit dhe ligjet e tjera dhe dispozitat.

Neni 20

Anëtari i Këshillit ka të drejtë të marrë pjesë në seancat e komisionit të Këshillit edhe pse nuk është anëtar i komisionit, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në punë, por pa të drejtë vendosjeje.

Neni 21

Anëtari Këshillit i cili me arsye është i penguar të marrë pjesë në seancën e Këshillit dhe në komisionin anëtar i të cilit është, është i obliguar që në kohë të informojë kryetarin e Këshillit dhe të komisionit.

Anëtari i Këshillit, i cili me arsye një periudhë më gjatë se 6 (gjashtë) muaj është i penguar të marrë pjesë në seancat e Këshillit dhe të komisionit anëtar i të cilit është, ka të drejtë të kërkojë nga Këshilli leje për mospjesëmarrje në seancë.

Sipas kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni, Këshilli vendos pa debat.

c) Kryetari i Këshillit

Neni 22

Kryetarin e Këshillit e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli me votim publik, me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Propozimin për zgjedhje dhe shkarkim të Kryetarit të Këshillit mund të japë çdo anëtar i Këshillit.

Zgjedhja e kryetarit të Këshillit mund të kryhet edhe me votim të fshehtë, nëse për një propozim të tillë të një anëtar i Këshillit vendos Këshilli me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

Procedurën për zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit të Këshillit me votim të fshehtë rregullohet me Rregulloren.

ç) Mënyra e punës

Neni 23

Këshilli punon në seanca të rregullta, kurse sipas nevojës mund të mbajë seanca solemne dhe të jashtëzakonshme.

Në seancat e Këshillit marrin pjesë Kryetari i Qytetit të Shkupit dhe drejtuesit e sektorëve të administratës së Qytetit të Shkupit.

Neni 24

Dita, ora dhe vendi i mbajtjes së seancës të Këshillit , si dhe propozimi i rendit të ditës sipas të cilit do të punohet në seancë, shpallen në tabelën e shpalljeve të Qytetit të Shkupit.

Kryetari i Këshillit mund të vendosë për ditën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës së Këshillit, si dhe propozimin për rendin e ditës të shpallet në mjetet e informimit publik.

Neni 25

Këshilli mban seanca solemne për festimin e ngjarjeve të rëndësishme historike, seancë solemne mund të mbahet edhe për të dëgjuar qeveritarë vendas dhe të huaj, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të qytetarëve të shquar të shteteve të huaja si mysafirë të Qytetit të Shkupit.

Neni 26

Seanca e jashtëzakonshme thërret për çështje të karakterit urgjent, për funksionimin e Qytetit të Shkupit (çështje që kërkojnë një shqyrtim urgjent; çështje me rëndësi nga fusha e sigurimit dhe mbrojtjes; shpëtimit të qytetarëve; në raste e rrethana të jashtëzakonshme etj).

Seancë të jashtëzakonshme thërret kryetari i Këshillit me iniciativën e tij, ose sipas kërkesës të së paku 1/3-ës së anëtarëve të Këshillit, ose me propozim të Kryetarit të Qytetit.

Ftesa për seancën e jashtëzakonshme bashkë me propozimin e rendit të ditës anëtarëve të Këshillit u jepet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Para fillimit me punë të seancës, anëtarët e këshillit votojnë për arsyeshmërinë e thirrjes së seancës së jashtëzakonshme, pa debat, me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

Neni 27

Në rast pengimi apo mungese të kryetarit të Këshillit, me seancën udhëheq anëtari më i vjetër i Këshillit.

Neni 28 (shlyhet)

Neni 29

Thirrja e seancës së Këshillit, përcaktimin i rendit të ditës, rrjedha e seancës, procesverbalet, procedura për sjelljen e akteve dhe çështje të tjera të lidhura me punën e Këshillit, prej së afërmi rregullohen me rregulloren.

2. Kryetari i Qytetit të Shkupit

Neni 30

Kryetari i kryen kompetencat e tij në kornizat e përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut.

Neni 31

Kryetari i Qytetit të Shkupit merr pjesë në punën e seancave të Këshillit, kurse sipas nevojës edhe në seancat e komisioneve të Këshillit dhe në organet e veçanta të Qytetit të Shkupit, pa të drejtë vendosjeje.

Kryetari i Qytetit të Shkupit mund të caktojë përfaqësues të tij të cilët marrin pjesë në punën e seancave të Këshillit, komisionet e tij dhe organet e veçanta të Qytetit të Shkupit.

Neni 32

Kryetari i Qytetit të Shkupit, të paktën një herë në vit, sipas nevojës, me iniciativën e tij ose me kërkesë të Këshillit, informon Këshillin për realizimin e punëve të caktuara nga kompetencat e tij.

Neni 33

Kryetari i Qytetit të Shkupit siguron shfrytëzimin e drejtë dhe të ligjshëm, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës së Qytetit.

Kryetari i Qytetit të Shkupit drejton me pronën e Qytetit në interes të shoqërisë dhe si një nikoqir i mirë.

Kryetari i Qytetit të Shkupit ka për detyrë me drejtimin e pronës së Qytetit të marrë masa dhe të sigurojë shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës së Qytetit në përputhje me ligjin.

Neni 34

Kryetari i Qytetit të Shkupit bashkëpunon me Kryetarët e komunave në territorin e Qytetit të Shkupit në kornizat e trupit Koordinues të kryetarëve të komunave, për çështje të përcaktuara me ligj.

Neni 35

Kryetari i Qytetit të Shkupit me aktvendim cakton anëtar të Këshillit që do ta zëvendësojë në rast pengimi apo mungese.

Aktvendimin nga paragrafi 1 i këtij neni Kryetari i Qytetit të Shkupit e merr në një afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së funksionit.

Aktvendimi nga paragrafi 1 shpallet në "Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit".

Në rast mungese ose pengimi, Kryetari i Qytetit të Shkupit e informon kryetarin e Këshillit dhe anëtarin e Këshillit që do ta zëvendësojë.

3. Trupa të veçanta të Qytetit të Shkupit

a) Komisioni për marrëdhënie mes bashkësive

Neni 36

Në Qytetin e Shkupit formohet komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (në tekstin e mëtutjeshëm : Komisioni).

Komisioni përbëhet nga 1 (një) përfaqësues nga bashkësitë që janë të përfaqësuara në Qytetin e Shkupit , me mandat 4 (katër) vjeçar. Anëtarët e Komisionit nuk mund të zgjidhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit.

Neni 37

Vendimin për formimin e Komisionit e sjell Këshilli, me propozim të Komisionit për verifikim, çështje mandatare për mirënjohje, parashtresa dhe ankesa.

Komisioni për verifikim, çështje mandatare për mirënjohje, parashtresa dhe ankesa, harton propozimin e paragrafit 1 të këtij neni në bazë të propozimeve të marra më parë nga anëtarët e Këshillit dhe partitë politike të përfaqësuara në Këshill.

Neni 38

Komisioni nga radhët e tij zgjedh kryetarin, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, me votim publik.

Neni 39

Komisioni punon në seanca.

Seancat i thërret dhe me to udhëheq kryetari i Komisionit.

Komisioni mund të punojë nëse në seancë janë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit.

Komisioni vendos me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit.

Në seancat e Komisionit mund të marrin pjesë në punë, Kryetari i Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Këshillit, pa të drejtë vendosjeje.

b) Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve

Neni 40

Në Qytetin e Shkupit formohet Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve.

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve përbëhet nga 10 anëtarë.

Anëtarët e Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve zgjidhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit të Qytetit të Shkupit, shoqatat e shpenzuesve dhe nga shoqata tjera civile, ndërmarrjet publike, odat ekonomike dhe nga organet shtetërore të

mbikëqyrjes inspektuese të cilat kanë kompetenca të lidhura me mbrojtjen e shpenzuesve.

Mandati i anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve është 4 vite.

Paragrafi 3 shlyhet.

Neni 41

Vendimin për formimin e Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve e sjell Këshilli i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit për verifikim, çështje mandatare për mirënjohje, parashtresa dhe ankesa.

Komisioni verifikim, çështje mandatare për mirënjohje, parashtresa dhe ankesa, harton propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, pas propozimeve të marra më parë nga anëtarët e Këshillit dhe të formave të vetëqeverisjes vendore në komunitat e Qytetit të Shkupit.

Neni 42

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve nga radhët e anëtarëve të tij zgjedh kryetarin, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve, me votim publik.

Neni 43

Komisioni për mbrojtjen e shpenzuesve punon në seanca.

Seancat sipas rregullit janë të hapura.

Seancat i thërret dhe me to udhëheq kryetari i Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve.

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve mund të punojë nëse në seancë janë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve.

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve vendos me shumicë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve.

Në seancat e Këshillit për mbrojtjen e shpenzuesve mund të marrin pjesë në punë Kryetari i qytetit dhe kryetari i Këshillit të Qytetit të Shkupit, pa të drejtë vendosjeje.

Neni 44

Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve shqyrton çështje dhe përcakton propozime të cilat kanë të bëjnë me kualitetin e shërbimeve të shërbimeve publike të Qytetit të Shkupit, veçanërisht:

- ndjek gjendjen e dhënies të shërbimeve nga shërbimet publike;
- kujdeset për zgjidhjen e problemeve që kanë qytetarët gjatë shfrytëzimit të shërbimeve nga ndërmarrjet dhe institucionet që kryejnë shërbime publike;
- kujdeset për avancimin e relacioneve të të punësuarve tek dhënësit e shërbimeve kundrejt shfrytëzuesve të shërbimeve;

- organizon tribuna publike dhe forma të tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve në të cilat do të diskutohet për përmirësimin e mbrojtjes së shpenzuesve.

Nën titulli c) Trupi participues ngafsha e urbanizmit dhe nenet 45, 46, 47 dhe 48 shlyhen.

c) Komisioni për avancimin e të drejtave të pacientëve

Neni 48-a

Në Qytetin e Shkupit formohet Komisioni për avancimin e të drejtave të pacientëve.

Komisioni për avancimin e të drejtave të pacientëve përbëhet nga nëntë anëtarë edhe atë: përfaqësues të pacientëve, anëtarë të shoqatave të pacientëve, dy përfaqësues të organizatave joqeveritare që merren me të drejtat njerëzore dhe iniciativa qytetare, dy mjekë të komunave dhe tre anëtarë të Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë të punësuar në institucione shëndetësore ku ofrohet mbrojtje shëndetësore.

Mandati i anëtarëve të komisionit është 2 vite, me të drejtë edhe për një zgjedhje të njëpasnjëshme.

Neni 48-b

Vendimin për formimin e Komisionit për avancimin e të drejtave të pacientëve e sjell Këshilli i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit për verifikim, çështje mandatare, për mirënjohje, parashtresa dhe ankesa.

Komisioni për verifikim, çështje mandatare, për mirënjohje, parashtresa dhe ankesa e përgatit propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni pas marrjes paraprake të propozimeve të anëtarëve të Këshillit, shoqatave të qytetarëve, organizatave joqeveritare që merren me të drejtat njerëzore dhe iniciativa qytetare.

Neni 48-c

Komisioni për avancimin e të drejtave të pacientëve nga radhët e anëtarëve të tyre zgjedh kryetar, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, me votim publik.

Neni 48-ç

Komisioni për avancimin e të drejtave të pacientëve punon në seanca.

Seancat sipas rregullit janë publike.

Seancat i thërret dhe me to udhëheq kryetari i Komisionit.

Komisioni mund të punojë nëse në seancë marrin pjesë shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Komisioni për avancimin e të drejtave të pacientëve vendos me shumicë nga numri i anëtarëve të pranishëm të Komisionit.

Neni 48-d

Komisionin për avancimin e të drejtave të pacientëve të Qytetit të Shkupit shqyrton çështje dhe përcakton propozime të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e pacientëve në territorin e Qytetit të Shkupit, në përputhje me kompetencat e Qytetit të Shkupit, të përcaktuara me dispozitat nga fusha e vetëqeverisjes lokale, dhe veçanërisht:

- i ndjek dhe vlerëson gjendjet në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pacientëve;
- propozon masa për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të pacientëve deri tek organet kompetente: institucione shëndetësore publike dhe private, inspektorate, Ministria për shëndetësi, Ministria për punë dhe politike sociale, Fondi për sigurim shëndetësor dhe organizata tjera të vendit dhe ndërkombëtare;
- bashkëpunon me organe kompetente dhe komisione tjera të formuara për avancimin e të drejtave të pacientëve;
- bashkëpunon me Këshillin e Qytetit të Shkupit dhe mediumet;
- shqyrton ankesa nga pacientë dhe propozon masa deri tek organet kompetente;
- siguron ekspertiza profesionale nëse vlerëson se ajo është e nevojshme për vërtetimin e gjendjes;
- mban evidencë për ankesa të veçanta të pacientëve, si dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve;
- përgatit plan vjetor të aktiviteteve;
- dorëzon raport vjetor për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve para Këshillit të Qytetit të Shkupit;
- ofron informacione, materiale promovuese dhe material tjetër me qëllim avancimin e të drejtave të pacientëve dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve.

dh) Komisioni për mundësi të njëjta të grave dhe burrave

Neni 48-dh

Në Qytetin e Shkupit formohet Komisioni për mundësi të njëjta të grave dhe burrave (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga radhët e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Mandati i anëtarëve të Komisionit është 4 vjet, përkatësisht derisa sa zgjat mandati i anëtarëve të Këshillit të Qytetit të Shkupit në përbërjen e të cilit është kryer zgjedhja.

Neni 48-e

Vendimin për formimin e Komisionit e sjell Këshilli i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit për verifikim, çështje mandatesh, për mirënjohje, parashtresa dhe ankesa.

Neni 48-ë

Komisioni zgjedh kryetar nga radhët e anëtarëve të vet, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, me votim të hapur.

Neni 48-f

Komisioni punon në seanca.

Seancat sipas rregullit janë publike.

Seancat i thërret dhe drejton me ta kryetari i Komisionit.

Komisioni mund të punojë nëse në seancë marrin pjesë shumica e anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Komisioni vendos me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Komisionit.

Neni 48-g

Komisioni shqyrton çështje dhe vërteton propozime të cilat kanë të bëjnë me mundësitë e njëjta dhe mos diskriminimin e grave dhe burrave në territorin e Qytetit të Shkupit, në përputhje me kompetencat e Qytetit të Shkupit, të vërtetuara me dispozitat nga fusha e vetëqeverisjes lokale, dhe veçanërisht:

- kujdeset për zbatimin konsekuent të dispozitave të Ligjit për mundësi të njëjta të grave dhe burrave, si dhe ligjeve të tjera nga fusha e mundësive të njëjta dhe mos diskriminimit dhe i propozon këshillit të Qyteti të Shkupi masa dhe aktivitete në drejtim të përmirësimit të mundësive të njëjta dhe mos diskriminimit mbi bazën e analizës për gjendjet e vërtetuara në fushën e kompetencave të Qytetit të Shkupit;
- identifikon dhe jep propozime për mënyrën e përfshirjes dhe formalizimit të principit të mundësive të njëjta dhe mos diskriminimit në punën e organeve të Qytetit të Shkupit dhe administratës së qytetit;
- merr pjesë gjatë krijimit të dokumenteve strategjike të Qytetit të Shkupit (strategji për zhvillim në sfera të veçanta nga kompetencat e Qytetit të Shkupit, buxheti i Qytetit, programi për punën e Këshillit, programe zhvilluese etj.
- jep mendim në lidhje me materialet dhe propozimet për seancat e Këshillit të Qytetit të Shkupit në suazat e kompetencave të tij”.

e) Këshilli i të rinjve

Neni 48-gj

Në Qytetin e Shkupit formohet Këshilli i të rinjve (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli i të rinjve), si organ këshillëdhënës i Qytetit të Shkupit, për shkak të nxitjes dhe mundësimin të përfshirjes aktive të të rinjve në jetën publike të Qytetit të Shkupit.

Të rinjtë janë banorë të qytetit të Shkupit nga moshë 15 deri në moshën 30 vjeçare.

Член 48-н

Këshilli i të rinjve kryen punët e mëposhtme:

- debaton për çështje të rëndësishme për punën e tyre,
- debaton për çështje për të cilat debaton Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe që janë me interes për punën e të rinjve,
- i propozon Këshillit të Qytetit të Shkupit, programe dhe akte të tjera me rëndësi për të rinjtë e qytetit të Shkupit,
- i propozon Këshillit të Qytetit të Shkupit të debatojë për çështje që janë të rëndësishme për avancimin e pozitës së të rinjve dhe zgjidhjen e problemeve të tyre,
- bashkëpunon në përgatitjen dhe ndjek realizimin e akteve lokale për të rinj, të sjella nga ana e Qytetit të Shkupit,
- përgatit raporte deri te organet kompetente për problemet e të rinjve, dhe sipas nevojës propozon sjelljen e Programit për mënjanimin e problemeve të shfaqura dhe avancimin e pozitës së të rinjve në nivel lokal,
- organizon punëtori, ligjërata, tribuna, fushata, manifestime dhe aktivitete të tjera në lidhje me çështjet e të rinjve,
- informon dhe promovon aktivitete të Këshillit të rinjve,
- nxit bashkëpunimin e ndërsjellë komunal dhe shkëmbimin e përvojave me të rinjtë nga komunat tjera,
- kryen dhe punë të tjera me interes për të rinjtë.

Neni 48-i

Këshilli i të rinjve ka 9 anëtarë.

Këshilli i të rinjve përbëhet nga: 5 përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe shoqatave të të rinjve dhe formave të tjera të regjistruara të organizimit të të rinjve, 2 përfaqësues të këshillave të nxënësve, dhe 2 përfaqësues të këshillave studentorë.

Vendim për formimin e Këshillit të të rinjve sjell Këshilli i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit për verifikim, çështje mandatare, mirënjohje, parashtrësia dhe ankesa.

Këshilli i të rinjve në përputhje me rregulloren për punë të Këshillit të të rinjve nga radhët e tij zgjedh kryetar dhe zëvendës.

Neni 48-j

Anëtarët e Këshillit të të rinjve zgjidhen në dy vjet.

Këshilli i Qytetit të Shkupit mund të shkarkojë anëtar të Këshillit të të rinjve dhe para përfundimit të mandatit me kërkesë personale, nëse mbush 30 vjet, nëse mungon nga seancat e Këshillit të të rinjve pa arsye, tre herë radhazi dhe nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor dënohet me burgim pa kusht në afat më të gjatë se gjashtë muaj.

Neni 48-k

Këshilli i të rinjve mban seanca të rregullta sipas nevojës, por së paku një në dy muaj.

Seancat i thërret dhe me të njëjtat udhëheq kryetari i Këshillit të të rinjve.

Kryetari i Këshillit obligohet të thërresë seancë të jashtëzakonshme të Këshillit të të rinjve me propozim të së paku 1/3 të anëtarëve të Këshillit të të rinjve.

Këshilli i të rinjve i sjell vendimet me shumicë votash nëse në seancë marrin pjesë shumica e anëtarëve të përgjithshëm të zgjedhur të Këshillit të të rinjve.

Mënyra e punës së Këshillit të të rinjve më hollësisht përcaktohet me rregulloren për punë të Këshillit të të rinjve.

Këshilli i të rinjve mund të formojë trupa të përhershëm dhe të përkohshëm pune për fushëveprimet më të ngushta, për organizimin e forumeve, tribunave dhe punëtorive për grupmosha të veçanta të të rinjve ose për probleme të cilat i tangojnë të rinjtë.

Neni 48-l

Këshilli i të rinjve, miraton programin e punës më vonë deri më 30 nëntor të vitit në rrjedhë, për vitin e ardhshëm dhe e dorëzon deri te Këshilli i Qytetit të Shkupit për marrjen e pëlqimit.

Programi përmban aktivitete të cilat në veçanti janë të fokusuara drejtë:

- krijimit dhe përcjelljes së programit lokal të punës për të rinjtë;
- bashkëpunimi me trupat tjerë këshillëdhënës të Republikës së Maqedonisë dhe nga shtetet e huaja;
- konsultimi me organizatat rinore për tema të rëndësishme për të rinjtë;
- bashkëpunimi me trupat në Qytetin e Shkupit, për krijimin dhe realizimin e politikës ndaj të rinjve.

Programi përmban edhe aktivitete tjera me rëndësi për punën e Këshillit për të rinjtë dhe përmirësimin e pozitës së tyre.

Programi për punën e Këshillit të rinjve, miratohet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të rinjve.

III. Organizimi dhe puna e komisioneve të Këshillit të Qytetit të Shkupit

1. Komisionet e Këshillit

Neni 49

Këshilli i formon këto komisione të përhershme:

- 1) Komisioni për verifikim, çështje mandatare, mirënjohje, parashtrësia dhe ankesa,
- 2) Komisioni për dispozita dhe punë administrative,
- 3) Komisioni për statut dhe rregullore,
- 4) Komisioni për buxhet,
- 5) Komisioni për urbanizëm dhe komunikacion,
- 6) Komisioni për punë komunale dhe mbrojtjen e ambientit jetësor,
- 7) Komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore,
- 8) Komisioni për kulturë,
- 9) Komisioni për sport dhe të rinj,
- 10) Komisioni për zhvillim ekonomik lokal,
- 11) Komisioni për mbrojtje sociale dhe shëndetësore dhe mbrojtjen e fëmijëve;
- 12) Komisioni për arsim,
- 13) Komisioni për siguri, mbrojtje dhe shpëtim,
- 14) Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar,
- 15) Komisioni për marrëdhëniet me komunat dhe shoqatat qytetare dhe fondacionet.
- 16) Komisioni për mbrojtjen e mjedisit jetësorë dhe të natyrës.

Neni 49-a

Komisioni për verifikim, çështje mandatare, mirënjohje, parashtrësia dhe ankesa:

- i dorëzon Këshillit propozim për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit, përcakton ekzistimin e shkaqeve dhe momentin e krijimit të kushteve për ndalimin ose marrjen e mandatit të anëtarit të Këshillit;
- shqyrton iniciativat për ndarjen e mirënjohjeve dhe jep propozime deri te Këshilli;
- shqyrton parashtrësit dhe ankesat e qytetarëve dhe subjekteve të tjera dhe propozon masa dhe aktivitete nga ana e subjekteve kompetente.

Kryetari i Komisionit është nga lista që ka numrin më të madh të mandateve për anëtarë të Këshillit, të zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta.

Neni 49-b

Komisioni për dispozita dhe punë administrative:

- shqyrton draftet dhe propozimet e vendimeve dhe të akteve të tjera të përgjithshme që i sjell Këshilli, nga pikëpamja e harmonizimit me Kushtetutën, ligjet dhe Statutin e Qytetit të Shkupit, si dhe nga pikëpamja e përgatitjes së tyre juridike dhe për të Këshillit të Qytetit të Shkupit i dorëzon raport me mendime dhe propozime;
- shqyrton kërkesat për dhënien e komenteve autentike dhe përgatitjen e propozimeve të komenteve autentike të vendimeve dhe akteve të tjera të përgjithshme që i sjell Këshilli;
- përcakton tekste të pastruara të vendimeve dhe akteve të tjera të Këshillit, nëse është e autorizuar për të me aktet;
- kryen krahasimin me tekstin burimor të vendimit të miratuar ose të aktit tjetër të Këshillit dhe jep korrigjime të gabimeve në tekstin e vendimit ose të aktit tjetër që është shpallur në “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit”;
- shqyrton vendimet dhe aktet e tjera të organeve të Qytetit të kontestuara para Gjyqit kushtetues të Republikës së Maqedonisë dhe përgatit përgjigje me kërkesë të Gjyqit kushtetues;
- i propozon Këshillit akte me të cilat përcaktohet vlera e kompensimit për pjesëmarrje në seanca dhe kompensimin e shpenzimeve të rrugës dhe shpenzimet ditore të anëtarëve të Këshillit.

Neni 49-c

Komisioni për statut dhe rregullore

- inicion iniciativa dhe analizon mendimet, propozimet dhe sugjerimet që kanë të bëjnë me Statutin e Qytetit të Shkupit dhe Rregulloren e Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe propozon ndryshimin dhe plotësimin e tyre.

Kryetari i Komisionit sipas funksionit është kryetar i Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Në punën e Komisionit merr pjesë edhe Kryetari i Qytetit të Shkupit

Neni 49-ç

Komisioni për buxhet:

- shqyrton çështje në lidhje me financimin e punëve nën kompetencat e Qytetit të Shkupit, realizimin e të ardhurave burimore të Qytetit dhe realizimit të shpenzimeve të planifikuara;
- shqyrton draftet dhe propozimet e buxhetit, ndryshimet e buxhetit, vendimet për shpërndarjen e mjeteve në buxhet, programet për zhvillim, raportet tremujore dhe raportet vjetore në lidhje me buxhetin dhe llogarinë vjetore të buxhetit.

Neni 49-d

Komisioni për urbanizëm dhe komunikacion:

- shqyrton çështje në lidhje me urbanizmin, planifikimin hapësinor dhe urbanistik, rregullimin e tokës ndërtimore, standardet për vendosjen e objekteve të përkohshme, mobilieve dhe pajisjeve urbane në territorin e qytetit të Shkupit, realizimin e programeve për ndërtimin e objekteve kapitale infrastrukturore dhe çështje të tjera;
- shqyrton edhe çështje në lidhje me zhvillimin e komunikacionit në qytetin e Shkupit, organizon transportin urban dhe mes urban të udhëtarëve, transportin auto-taksi, parkingjet publike me rëndësi për Qytetin e Shkupit dhe përcakton propozime për anëtarë të organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjeve publike për transport dhe për parkingjet publike, themelues i të cilave është Qyteti i Shkupit.

Neni 49-dh

Komisioni për punë komunale

- shqyrton çështje nga fusha e veprimtarive komunale edhe atë: furnizimin me ujë dhe mënjanimi i ujërave të zeza, menaxhimi me mbeturinat, menaxhimi me mbeturinat, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, park – pyjeve, zonave sportive – rekreative dhe territoreve të tjera të mbrojtura, mirëmbajtja, mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe të komunikacionit, furnizimi me energji të ngrohtësisë, mirëmbajtja e varrezave, dezinfeksioni, trajtimi i kafshëve endacake, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e tregjeve me tregti të madhe dhe tregjeve për shitje të automjeteve dhe përcakton propozime për anëtarët e organeve të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes në ndërmarrjet publike nga fusha komunale, themelues i të cilëve është Qyteti i Shkupit.

Neni 49-e

Komisioni për emërimin e rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore :

- e shqyrton problematikën lidhur me emërtimin e rrugëve, shesheve dhe objekteve të tjera infrastrukturore dhe shënimin e tyre, si dhe propozimet për emërimin e rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore.

Neni 49-ë

Komisioni për kulturë:

- shqyrton çështje në lidhje me organizimin, zhvillimin dhe avancimin e kulturës;
- zhvillimin e rrjetit të institucioneve;
- nxitjen e krijimtarisë;
- mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë kulturore;
- veprimtarinë e muzeve dhe bibliotekave;
- realizimin e aktiviteteve të definuar programore;
- shënimin e ngjarjeve dhe personaliteteve me rëndësi për qytetin e Shkupit dhe çështje të tjera me rëndësi për kulturën dhe
- përcakton propozime për anëtarët e organeve të udhëheqjes në institucionet nga fusha e kulturës.

Neni 49-f

Komision për sport dhe të rinj:

- shqyrton çështje në lidhje me zhvillimin e institucioneve nga fusha e sportit, zhvillimit dhe avancimit të kulturës fizike, zhvillimin e sportit masiv dhe aktiviteteve sportive, manifestimet sportive dhe çështje të tjera – me rëndësi për sportin;
- shqyrton çështje në lidhje me arsimin dhe edukimin e të rinjve, nxitjen e krijimtariës së të rinjve, edukimin për mbrojtje parandaluese të të rinjve nga sëmundjet e varësive dhe nga sëmundjet ngjitëse dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me të rinjtë.

Neni 49-g

Komisioni për zhvillim ekonomik lokal:

- shqyrton dhe analizon çështje, dukuri dhe probleme nga fusha e zhvillimit ekonomik lokal, si dhe çështje që kanë të bëjnë me tregtinë, turizmin, hotelerinë, zejtarinë dhe mbrojtjen e shpenzuesve.

Neni 49-gj

Komisioni për mbrojtje sociale dhe shëndetësore dhe mbrojtje të fëmijëve:

- shqyrton çështje në lidhje me realizimin e kujdesit social për personat me nevoja të posaçme; fëmijët pa prindër dhe kujdes prindërorë, fëmijët me probleme edukativo – sociale, fëmijët me nevoja të posaçme, fëmijët prej familjeve me një prindër, fëmijët në rrugë, persona të ekspozuar në rrezik social, persona të cenuar me keqpërdorim të drogave dhe alkoolit, ngritjen e vetëdijes së popullatës, përkujdesjen e personave me rrezik social, organizimi i mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve;
- e përcakton nevojën për themelim dhe ndërprerje të institucioneve sociale dhe institucionit për mbrojtje të fëmijëve;
- i shqyrton statutet, programet e punës, planet financiare dhe llogaritë përfundimtare, raportet e funksionimit të institucioneve sociale dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve si dhe përcakton propozime për anëtarët e këshillave drejtues në institucionet sociale dhe institucionet për mbrojtje të fëmijëve themelues i të cilave është Qyteti i Shkupit;
- shqyrton çështje në lidhje me mbrojtjen shëndetësore të popullatës, avancimin e shëndetit, aktivitetet parandaluese, edukimin shëndetësorë, punën e institucioneve publike shëndetësore nga mbrojtja primare shëndetësore, mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet ngjitëse, nga ndikimet e dëmshme të gazrave, rrezatimeve jonizuese dhe zhurmës, ndotjet e ajrit, ujit, tokës dhe prodhimeve jetësore, ndihmën e personave me nevoja speciale dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me shëndetësinë si dhe përcakton

propozime për anëtarët e organeve udhëheqëse në institucionet publike shëndetësore themelues i të cilave është Qyteti i Shkupit.

Neni 49-h

Komisioni për arsim:

- shqyrton çështje në lidhje me organizimi e arsimit të mesëm, rrjetit të shkollave të mesme, themelimin dhe pushimin e punës të shkollave të mesme, statutet, programet e punës, programet mësimore, planet financiare, llogaritë vjetore dhe raportet e punës të shkollave të mesme, punën e këshillave shkollore dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me arsimin e mesëm si dhe përcakton propozime për anëtarët e këshillave shkollor .

Neni 49-i

Komisioni për siguri, mbrojtje dhe shpëtim:

- shqyrton çështje në lidhje me sigurinë, mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarret;
- e shqyrton raportin vjetor për sigurinë publike në territorin e qytetit të Shkupit, raportet për punën e Brigadës për mbrojtje kundër zjarreve të Qytetit të Shkupit, vlerësimin për rrezikimet dhe planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore, epidemitë, epizotët, epifiotët dhe fatkeqësitë në territorin e Qytetit të Shkupit dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë, mbrojtjen dhe shpëtimin dhe mbrojtjen;
- rekomandon masa deri te njësitë rajonal i Ministrisë për punë të brendshme nga fusha e sigurisë dhe sigurisë në komunikacion dhe
- jep mendime në lidhje me propozimin për zgjedhje të personit që do të udhëheq me njësitin rajonal të Ministrisë për punë të brendshme.

Neni 49-j

Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar:

- shqyrton çështje lidhur me realizimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit të Qytetit të Shkupit dhe organeve të tij me njësitë e vetëqeverisjes lokale të shteteve të tjera dhe organeve të tyre, me organizatat dhe institucione të huaja ndërkombëtare;
- i propozon Këshillit forma konkrete të bashkëpunimit, si dhe materiale të tjera, mendime dhe propozime që do të pasojnë nga bashkëpunimi;
- i shqyrton çështjet e vëllazërimit të Qytetit të Shkupit me kryeqytetet dhe qytetet tjera të shteteve të huaja dhe i shqyrton çështjet e anëtarësimit të Qytetit të Shkupit në organizatat ndërkombëtare të pushtetit lokal;
- realizon bashkëpunim me organet shtetërore kompetente lidhur me çështjet e bashkëpunimit të Qytetit të Shkupit me kryeqytetet e shteteve të tjera, si dhe në realizimin e aktiviteteve tjera ndërkombëtare dhe protokollare.

:

Neni 49-k (shlyhet)

Neni 49-I

Komisioni marrëdhënie dhe bashkëpunim me komunat dhe shoqatat qytetare dhe fondacionet:

- shqyrton çështje në lidhje me marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e Qytetit të Shkupit me komunat në qytetin e Shkupit dhe me shoqatat qytetare dhe fondacionet në territorin e qytetit të Shkupit, masat dhe aktivitetet për avancim të këtyre marrëdhënieve dhe bashkëpunimit dhe për përkrahje të aktiviteteve të shoqatave qytetare dhe fondacioneve dhe çështje të tjera.

Neni 49-II

Komisioni për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës:

- shqyrton çështje të lidhura me mbrojtjen e ambientit jetësor, mbrojtjen e ajrit dhe ujit nga ndotja dhe pengimin e zhurmës së dëmshme; mbrojtjen e natyrës; mbrojtjen nga rrezatimi i jonizuar dhe veprime të tjera të dëmshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe masat për mbrojtje dhe çështje të tjera.

2. Zgjedhja dhe mënyra e punës së komisioneve

Neni 50

Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit bëhet me propozim të anëtarëve të Këshillit, me ç'rast mbahet llogari për zbatimin e parimit për përfaqësimin proporcional të partive politike të përfaqësuara në Këshill, duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të komisioneve të Këshillit.

Zgjedhja e kryetarit dhe e anëtarëve të komisionit realizohet me shumicë të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

Neni 50-a

Kryetari i komisionit:

- organizon punën e komisionit;
- jep iniciativë për shqyrtimin e çështjeve të caktuara nga fushëveprimi i komisionit;
- kujdeset për informimin e anëtarëve të komisionit dhe Këshillit për problemet nga fushëveprimi i komisionit;
- thërret seancat e komisionit dhe udhëheq me punën e të njëjtit;

- propozon rendin e ditës së seancës;
- formulon konkluzionet e komisionit dhe kujdeset për zbatimin e tyre,
- sipas nevojës i paraqet qëndrimet e komisionit në seancat e Këshillit dhe
- kryen edhe punë të tjera që përcaktohen me këtë statut.

Në rast pengese ose mungese, kryetarin e zëvendëson anëtar i komisionit të cilin do ta caktojë anëtarët e komisionit.

Neni 51

Zgjedhja për shkak të ndryshimit të një anëtari të caktuar të komisionit kryhet në propozim të anëtarëve të Këshillit, gjatë kësaj me propozimin e dhënë nuk duhet të cenohet parimi i përfaqësimit proporcional të partive politike të përfaqësuara në Këshill dhe në komisionet e Këshillit.

Neni 52

Propozim për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit mund të japë çdo anëtar i Këshillit.

Për propozimin për shkarkim vendos Këshilli me votim publik, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

Neni 52-a (fshihet)

Neni 53

Komisionet punojnë në seanca.

Kryetari i komisionit është i detyruar të thërrasë seancë nëse atë e kërkon kryetari i Këshillit ose të paktën tre anëtarë të komisionit, duke theksuar çështjen që duhet të vihet në rendin e ditës së seancës.

Nëse kryetari i komisionit nuk thërret seancë kur është i obliguar ta bëjë atë, seancën mund ta thërrasë kryetari i Këshillit.

Nëse me kërkesë të më së paku tre anëtarëve të komisionit seancë nuk thërret as kryetari i komisionit dhe as kryetari i Këshillit, seancë mund të thërrasin anëtarët e komisionit që e kanë kërkuar atë.

Neni 53-a

Komisionet shqyrtojnë çështje nga fushëveprimi i tyre me iniciativën e vetë, dhe janë të obliguar të shqyrtojnë secilën çështje nga fushëveprimi i tyre, shqyrtimin e së cilës do ta kërkojë kryetari i Këshillit dhe kryetari i Qytetit.

Iniciativë për futjen e çështjeve të caktuara në rendin e ditës të propozuar të seancës së komisionit mund të japin anëtarët e Këshillit, komisione të tjera të Këshillit, si dhe shërbimet publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit.

Neni 53-b

Ftesën për seancë së bashku me rendin e ditës të propozuar dhe materialet që do të shqyrtohen në seancë, kryetari i komisionit ua dërgon anëtarëve të komisionit më së voni 3 ditë para ditës së mbajtjes së seancës.

Sipas përjashtimit, kryetari mund të thërrasë seancë edhe në afat më të shkurtër kohor.

Kryetari i komisionit për seancën e thërritur njofton propozuesit e materialeve që do t'i shqyrtojë komisioni, me qëllim që të caktojnë përfaqësues për pjesëmarrje në seancë.

Neni 53-v

Rendi i ditës i seancës së komisioneve përcaktohet në fillim të seancës.

Shqyrtimi i çështjeve të cilat janë në rendin e ditës së komisionit mund të përfundojë me kalim të thjeshtë në pikën tjetër të rendit të ditës ose me sjelljen e konkluzionit, gjë për të cilën mund të paraqesë raport para Këshillit.

Neni 53-g

Komisioni mund t'i propozojë Këshillit ta prolongojë shqyrtimin e një çështje të caktuar të cilën e shqyrton komisioni, e cila është pjesë përbërëse e rendit të ditës të propozuar për seancën e Këshillit.

Neni 53-d

Procesverbalet dhe raportet e seancës së komisionit i nënshkruan kryetari i komisionit.

Raportet e Komisionit i dërgohen Këshillit para fillimit të seancës.

Neni 54

Komisionet mund të punojnë nëse në seancë marrin pjesë shumica e anëtarëve të komisionit.

Komisionet vendosin me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 55

Kur vendosin t'i paraqesin raport ose propozim Këshillit, komisionet caktojnë raportuesin e tyre, i cili, me urdhër të komisionit, me iniciativën e tij ose me kërkesë të Këshillit, në seancën e Këshillit do të arsyetojë qëndrimin ose propozimin e komisionit

Neni 56

Në seancën e komisioneve merr pjesë përfaqësuesi i propozuesit.

Përfaqësuesi i propozuesit ka të drejtë në seancën e komisionit, të marrë pjesë në shqyrtimin e propozimit të paraqitur, të japë arsytetime dhe sqarime për propozimin, të propozojë ndryshime të tij, korrigjime dhe plotësime, të deklarohet në

lidhje me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara nga anëtarët e komisionit, të kërkojë shtyrjen e shqyrtimit, përkatësisht, në emër të propozuesit të tërhiqet nga procedura e mëtejshme propozimi i paraqitur.

Neni 57

Komisionet kanë të drejtë të kërkojnë nga propozuesi raportim, sqarim si dhe të dhëna të tjera që janë të nevojshme për punën, me të cilat disponon propozuesi ose është i obliguar t'i mbledhë dhe t'i evidentojë.

Neni 58

Komisionet mund të ftojnë në seancat e tyre përfaqësues të organeve, organizatave, bashkësive dhe shoqatave, si dhe punëtorë shkencorë, profesionalë dhe publikë për shkak të prezantimit të mendimeve të tyre për çështje që shqyrtohen në seancën e komisionit.

Ftesën për personat nga paragrafi 1 i këtij neni, e dërgon kryetari pas konsultimit paraprak me anëtarët e komisionit.

Neni 58-a

Komisionet për çështje nga kompetencat e tyre japin iniciativa, mendime dhe propozime në Këshillin e Qytetit të Shkupit

IV. Kryerja e punëve sipas parimit të subsidiaritetit

Neni 59

Qyteti i Shkupit, në suazat e ligjit, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, ka të drejtë në territorin e vet të kryejë aktivitete me interes publik me rëndësi për Qytetin e Shkupit, të cilat nuk janë të përjashtuara nga kompetenca e tij ose nuk janë në kompetencë të organeve të pushtetit shtetëror.

Përcaktimi i aktiviteteve nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktimi i përmbajtjes së tyre, mënyra dhe procedura për kryerjen e tyre rregullohen me vendime të veçanta të Këshillit.

V. Informimi i qytetarëve dhe qasja e lire në informacionet me karakter publik

a) Informimi i qytetarëve

Neni 60

Organet e Qytetit të Shkupit, komisionet e Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe shërbimet publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit informojnë qytetarët për vendimet dhe aktivitetet e tyre që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për jetën dhe punën e qytetarëve në Qytet dhe për informacione të tjera me interes publik.

Qytetarët informohen për:

- dispozitat e miratuara nga Këshilli i Qytetit të Shkupit;
- mënyrën dhe kushtet për realizimin e të drejtave të tyre;
- obligimet e qytetarëve që rrjedhin nga kompetencat e Qytetit të Shkupit;
- planet, projektet dhe programet, që janë në përgatitje, dhe që janë me rëndësi për zhvillimin e Qytetit të Shkupit;
- shërbimet që i marrin nga shërbimet publike dhe administrata e qytetit dhe mënyrën e marrjes së tyre;
- të ardhurat që realizohen në Qytetin e Shkupit dhe mënyrën e shpërndarjes dhe shpenzimit të tyre;
- furnizimet publike;
- emërimin e drejtorëve dhe përfaqësuesve në këshillat drejtuese të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike;
- informacione të tjera që rrjedhin nga kompetencat e organeve të Qytetit të Shkupit dhe shërbimeve publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit, në përputhje me ligjin.

Neni 61

Informimi i qytetarëve kryhet rregullisht, pa kompensim, nëpërmjet:

- botimit të “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit”;
- botimit dhe distribucionit të buletineve informative mujore të qytetarët;
- botimit të publikimeve;
- zyrave informative të drejtuara nga administrata e qytetit dhe shërbimet publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit;
- tabelave për shpallje (hapësira të organeve të Qytetit të Shkupit, shërbimet publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit, vetëqeverisja lokale);
- ueb-sajt-portal;
- tribunave publike;
- mjeteve për informim publik dhe
- ndonjë mënyre tjetër adekuate që është më e volitshme për informimin e publikut.

Neni 62

Informimi i qytetarëve kryhet në gjuhët zyrtare që përdoren në Qytetin e Shkupit.

Këshilli i Qytetit të Shkupit me vendim të veçantë mund të përcaktojë që për informata të caktuara të informohet edhe në gjuhën e cila nuk është gjuhë zyrtare në Qytetin e Shkupit, dhe të cilën e flasin një pjesë e banorëve të Qytetit.

b) Qasja e lirë në informacionet me karakter publik

Neni 63

Në Qytetin e Shkupit sigurohet e drejta për qasje të lirë në informacionet me karakter publik me të cilat disponojnë organet e Qytetit të Shkupit (Këshilli dhe

kryetari i Qytetit të Shkupit), shërbimet publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit dhe personat juridikë dhe fizikë që kryejnë autorizime publike të besuara nga Qyteti i Shkupit.

Sipas përjashtimit, në raste të përcaktuara me ligj, e drejta për qasje të lirë në disa informacione me të cilat disponojnë poseduesit e informacioneve nga paragrafi 1 i këtij neni mund të kufizohet ose të sigurohet qasje e pjesshme.

Neni 64

Për informacionet me të cilat disponojnë dhe për të cilat sigurohet qasje e lirë, poseduesit e informacioneve duhet të krijojnë dhe drejtojnë listën e informacioneve e cila publikohet në atë mënyrë që të jenë në dispozicion të kërkuesve të informacionit.

Për listën e informacioneve dhe kushteve si dhe mënyrën e qasjes së lirë në informacione, qytetarët informohen nëpërmjet tabelës së shpalljeve ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme.

Poseduesit e informacioneve janë të obliguar çdo tre muaj të azhurnojnë rregullisht listën e informacioneve me karakter publik me të cilën disponojnë.

Listën e informacioneve me karakter publik për organet e Qytetit të Shkupit e propozon kryetari i Qytetit të Shkupit, dhe konfirmohet nga Këshilli.

Lista e informacioneve me karakter publik për shërbimet publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit konfirmohet nga këshilli drejtues me propozim të drejtorit.

Neni 65

Procedura për realizimin e së drejtës për qasje të lirë në informacione realizohet në përputhje me ligjin.

Kryetari i Qytetit të Shkupit krijon kushte dhe merr masa të përcaktuara me ligj për realizimin e të drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik me të cilat disponon Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe administrata e qytetit.

Drejtori i shërbimeve publike të themeluara nga Qyteti i Shkupit krijon kushte dhe merr masa të përcaktuara me ligj për realizimin e së drejtës për qasje të lirë në informacionet publike me të cilat disponon në përputhje me statutin e ndërmarrjes dhe të institucionit.

Neni 66

Qasje të lirë në informacionet publike me të cilat disponojnë poseduesit e informacioneve kanë të gjithë personat juridikë dhe fizikë (në tekstin e mëtejshëm: kërkuesi i informacionit).

Qasja e lirë në informacione realizohet në afatin e përcaktuar ligjor:

- me kontrollin e dokumenteve me të cilat disponon poseduesi i informacionit;
- me marrjen e kopjes, fotokopjes ose regjistrimit elektronik të dokumenteve me të cilat disponon poseduesi i informacionit

Poseduesi i informacionit për ndërmjetësimin gjatë realizimit të së drejtës për qasje të lirë në informacione cakton person zyrtar.

Neni 67

Kërkuesi i informacionit për kontrollin e bërë ose për kopjen e marrë, fotokopjen e regjistrimit elektronik të informacionit, paguan kompensimin adekuat në vlerën e shpenzimeve materiale, të përcaktuara në mënyrë të rregulluar me ligj.

Kërkuesi i informacionit gjatë dorëzimit të kërkesës informohet për pagesën dhe vlerën e kompensimit adekuat.

Neni 68

Kërkuesi i informacionit ka të drejtë për ankesë pranë organit kompetent për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacionet publike nëse poseduesi i informacionit nuk e dorëzon informacionin e kërkuar.

Neni 69

Këshilli i Qytetit të Shkupit miraton raport vjetor për realizimin e së drejtës për qasje të lirë në informacione gjatë vitit të kaluar në Qytetin e Shkupit .

Raportin vjetor për realizimin e qasjes së lirë në informacione e përgatit kryetari i Qytetit të Shkupit dhe ia dorëzon Këshillit më së voni deri më 31 janar të vitit në vijim.

Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni përmban edhe të dhënat për realizimin e qasjes së lirë në informacione me të cilat disponojnë edhe shërbimet publike të krijuara nga Qyteti i Shkupit.

Raporti nga paragrafi 1, pas miratimit dorëzohet tek organi kompetent për mbrojtjen e qasjes së lirë në informacionet me karakter publik.

VI. Përrjashtimi i publikut nga seancat e Këshillit

Neni 70

Këshilli mund të punojë pa prezencën e publikut në rastet kur debaton për materiale të cilat mbajnë shenjën e fshehtësisë, si dhe për çështje për të cilat atë do ta propozojnë kryetari i Këshillit, kryetari i Qytetit ose më së paku 10 (dhjetë) anëtarë të Këshillit.

Në lidhje me propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli vendos pa debat, me shumicë të cilësuar të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

VII. Parashtrësia dhe propozime

Neni 71

Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të deponojnë parashtrësia dhe propozime në lidhje me punën e organeve të Qytetit të Shkupit dhe administratës së qytetit.

Neni 72

Parashtresat dhe propozimet paraqiten me shkrim ose gojarisht në procesverbal para një personi të autorizuar në administratën e qytetit.

Për parashtresat dhe propozimet nuk paguhet asnjë pagesë.

Neni 73

Parashtruesi nuk duhet të ketë pasoja të dëmshme për shkak të paraqitjes së parashtresës ose propozimit, dhe as nuk mund të mbajë përgjegjësi për këtë arsye.

Neni 74

Kryetari i komunës, në varësi të përmbajtjes së parashtresës, përkatësisht propozimit, autorizon një ose më shumë nëpunës të veprojnë sipas parashtresës, përkatësisht propozimit.

Parashtresa që ka të bëjë me çështje që lidhen me punën e Këshillit, i dërgohet kryetarit të Këshillit.

Veprimi sipas parashtresës, përkatësisht propozimit, përfshin grumbullimin e të dhënave, njoftimeve dhe mendimeve për rrethanat të cilat janë të rëndësishme për vlerësimin e drejtë të asaj mbi të cilën bazohet parashtresa apo arsyeshmëria e propozimit, si dhe marrjen e masave të nevojshme për të mënjeluar shkeljen eventuale të së drejtës së parashtruesit ose dëmtimit të interesit publik.

Neni 75

Kryetari i Qytetit është i obliguar në një afat sa më të shkurtër kohor, dhe më së voni deri në 60 ditë nga dita e pranimit të parashtresës, përkatësisht propozimit, t'i dërgojë përgjigje parashtruesit.

VIII. Tribuna publike, anketa dhe propozime të qytetarëve

Neni 76

Organet e Qytetit të Shkupit, për shkak të konfirmimit të politikës në një fushë të caktuar, marrjes së masave për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve me rëndësi për qytetarët në territorin e Qytetit të Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit, si dhe gjatë propozimit të akteve të caktuara në kompetencat e tij mund të organizojnë tribuna publike, të realizojnë anketë ose të mbledhin propozime nga qytetarët.

Lloji, procedura, mënyra dhe koha e organizimit të formave të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve nga paragrafi 1 i këtij neni do të rregullohen me një akt të organit që e organizon.

Për organizimin e një tribune publike, realizimin e anketës dhe mbledhjes së propozimeve nga qytetarët publikohet shpallje në mjetet e informimit publik, në të cilën caktohet lloji, qëllimi, lënda dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për organizimin e formës adekuate të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe ftohen të interesuarit për pjesëmarrjen e tyre.

Organizimi i tribunës publike, realizimi i anketës dhe mbledhja e propozimeve nga qytetarët, mund të kryhet në bashkëpunim me komunat e qytetit të Shkupit dhe me format e vetëqeverisjes lokale.

Për tribunën publike, anketën ose propozimet e qytetarëve përgatitet raport.

Neni 77

Gjatë organizimit të tribunës publike, realizimit të anketës dhe mbledhjes së propozimeve nga qytetarët do të sigurohet:

- shpallja e një pyetjeje të përcaktuar, teksti të një dokumenti ose draft-vendimi dhe akti tjetër të përgjithshëm në gazetën ditore ose si pjesë e veçuar për të qenë në dispozicion qytetarëve dhe subjekteve të tjera të interesuara;
- mbledhja dhe shqyrtimi i mendimeve dhe propozimeve që janë paraqitur dhe përgatitja e raportit.

Neni 78

Mënyra dhe procedura e organizimit të tribunës publike, realizimit të anketës dhe mbledhjes së propozimeve nga qytetarët rregullohet me Rregulloren.

IX. Realizimi i obligimeve nga fusha e mbrojtjes në gjendje lufte

Neni 79

Në gjendje lufte, organet e Qytetit të Shkupit:

- vazhdojnë të kryejnë detyrat e përcaktuara me ligj dhe
- marrin masa për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale në territorin e vet nga shkatërrimet e luftës dhe nga pasojat e shkaktuara prej saj.
- Qyteti i Shkupit përgatitet për realizimin e obligimeve nga paragrafi 1 i këtij neni nëpërmjet:
 - planifikimit dhe organizimit të masave për mbrojtje dhe shpëtim nga shkatërrimet e luftës për nevojat e veta përmes Shtabit të qytetit për mbrojtje dhe shpëtim, në përputhje me ligjin dhe dispozitat e bazuara në ligj;
 - trajnimit për mbrojtje, përkatësisht përfshirjes në aktivitete për fitimin e njohurive të nevojshme ushtarake-profesionale dhe njohurive të tjera për të marrë pjesë në mbrojtje;
 - marrjes së masave, aktiviteteve dhe procedurave për mbrojtjen dhe ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve nga fusha e mbrojtjes, në përputhje me ligjin dhe dispozitat e bazuara në ligj;
 - koordinimit dhe bashkëpunimit me komunat në Qytetin e Shkupit.

X. Mënyra e realizimit të obligimeve nga fusha e sigurisë, mbrojtjes dhe shpëtimit në kushtet e gjendjes së krizës dhe fatkeqësive elementare

Neni 80

Në kushtet e krizës dhe fatkeqësive elementare organet e Qytetit të Shkupit:

- vazhdojnë të kryejnë detyrat e përcaktuara me ligj;

- identifikojnë nevojat dhe planifikojnë resurset për të eliminuar krizën;
- marrin masa për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale në rajonin e tyre nga fatkeqësitë natyrore, epidemitë, epizotet, epifitotet dhe fatkeqësitë e tjera dhe nga pasojat e shkaktuara prej tyre.

Qyteti i Shkupit përgatitet për realizimin e obligimeve nga paragrafi 1 i këtij neni nëpërmjet:

- planifikimit dhe organizimit të masave për mbrojtjen, shpëtimin dhe menaxhimin me krizën për nevojat e veta nëpërmjet Shtabit të Qytetit për mbrojtje, shpëtim dhe menaxhim me krizat dhe formacioneve hapësinore për mbrojtje dhe shpëtim, në përputhje me ligjin dhe dispozitat e bazuara në ligj,
- sigurimit të koordinimit të pjesëmarrësve në sistemin e menaxhimit me kriza në Qytetin e Shkupit dhe komuna.

XI. Mënyra e shpalljes së dispozitave të Këshillit

Neni 81

Dispozitat e Këshillit shpallen në Lajmëtarin zyrtar të Qytetit të Shkupit para se të hyjnë në fuqi.

Buletini zyrtar i Qytetit të Shkupit është "Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit".

Paragrafi 3 fshihet.

Neni 82

Dispozitat e Këshillit të Qytetit të Shkupit hyjnë në fuqi ditën e shpalljes së tyre në "Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit", përveç dispozitave, të cilat në përputhje me ligjin hyjnë në fuqi ditën e tetë pas ditës së shpalljes.

XII. Mënyra dhe procedura e përcaktimit të stemës dhe flamurit të Qytetit të Shkupit

Neni 83

Iniciativa për ndryshimin e stemës dhe flamurit të Qytetit të Shkupit mund të jepet nga partitë politike të përfaqësuara në Këshill.

Këshilli, duke vepruar sipas iniciativës nga paragrafi 1 i këtij neni, mundet me vendim të përcaktojë arsyeshmërinë për ndryshimin e stemës dhe flamurit të qytetit, si dhe fillimin e procedurës për ndryshimin e tyre.

Vendimin nga paragrafi 2 i këtij neni, Këshilli e miraton me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit, gjatë së cilës duhet të ketë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit, që u përkasin komuniteteve që nuk janë popullsi shumicë në Qytet.

Në rastin e mospranimit të iniciativës nga paragrafi 1 i këtij neni, iniciativa e re për ndryshimin e stemës dhe flamurit të qytetit nuk mund të deponohet para skadimit të periudhës prej një (1) viti nga dita e mbajtjes së seancës së Këshillit në të cilën nuk është pranuar iniciativa.

Neni 84

Për ndryshimin e stemës dhe flamurit të Qytetit të Shkupit, Këshilli shpall konkurs për zgjidhje ideore dhe formon komision.

Neni 85

Komisioni, nga punimet e marra, pas konkursit të shpallur përcakton propozimin për stemën, përkatësisht flamurin dhe e dërgon atë në Këshill për miratim.

Neni 86

Këshilli vendos në lidhje me propozimin e komisionit me shumicë votash nga paragrafi 3 i nenit 83 të këtij Statuti.

XIII. Ndryshimi dhe plotësimi i statutit

Neni 87

Iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qytetit të Shkupit mund të dërgojë anëtar i Këshillit, komision i Këshillit dhe subjekte të tjera.

Për iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit vendos Këshilli me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Neni 88

Pas miratimit të iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit, Kryetari i Qytetit përgatit propozim për vendimin statusor për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

XIV. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 89

Poseduesit e informacioneve nga neni 63 paragrafi 1 i këtij statuti janë të obliguar, brenda gjashtë muajve nga dita e sjelljes së këtij statuti, të sjellin dhe shpallin listën e informacioneve nga neni 64 i këtij statuti.

Neni 90

Kryetari i Qytetit, në afat kohor prej tre muajsh nga dita e sjelljes së këtij statuti, në përputhje me aktin për organizimin e administratës së qytetit, do të ngarkojë një nëpunës shtetëror nga administrata e qytetit i cili do të kryejë punët e ndërmjetësimit gjatë realizimit të së drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.